



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**RREGULLORE (QRK) - NR. 06/2026**  
**PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT TË**  
**ZJARRFIKËSVE<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore (QRK) – Nr.06/2026 për Zhvillimin e Procedurave të Rekrutimit për Zjarrfikës, e miratuar në Mbledhjen e 30 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendim 02/30, të datës 24.07.2026

## **Qeveria e Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 81, paragrafi 8, nenit 82, paragrafi 4, nenit 83, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L- 197 për Zyrtarët Publikë, (Gazeta Zyrtare, Nr.21/18, shtator 2023), nenit 8, paragrafit 4, nënparagrafi 4.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

### **RREGULLORE (QRK) NR. 06/2026 PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT TË ZJARRFIKËSVE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për pranimin e zjarrfikësve në Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, në pajtim me parimet themelore të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë (në tekstin e mëtejshëm: LZP).

#### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për shërbimin publik në Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit për pozitën e zjarrfikësit.

#### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **LZP** – nënkupton Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë;

1.2. **Pranimi në shërbimin publik** – nënkupton pranimin në të gjitha kategoritë e shërbimit publik, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Rregullore;

1.3. **NjMBNj** – nënkupton Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;

1.4. **SIMBNj** – nënkupton Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;

1.5. **AME** – nënkupton Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;

1.6. **NJPZSH** – nënkupton Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit;

1.7. **Zjarrfikës** – nënkupton personin e aftësuar profesionalisht për të marrë pjesë në aktivitetet e shuarjes së zjarrit dhe të shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë.

1.8. **Zjarrfikës praktikant** – nënkupton personin në fazën e punës provuese dhe të aftësimit/trajnimit për të marrë pjesë në aktivitetet e shuarjes së zjarrit dhe të shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në LZP dhe në Ligjin për Zjarrfikjen dhe Shpëtimin.

3. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në njërin gjini nënkuptojnë edhe gjininë tjetër.

#### **Neni 4**

##### **Parimet e pranimi**

1. Pranimi në shërbimin publik bazohet në parimin e meritës, të mundësive të barabarta, të profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit, si dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor e të komuniteteve.

2. Nëpunësit e shërbimit publik në Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit pranojnë në bazë të meritës përmes një procedure të hapur dhe konkurruese, të përcaktuar në përputhje me LZP-në dhe këtë Rregullore.

#### **Neni 5**

##### **Procedura e pranimi**

Pranimi në shërbimin publik në Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit bëhet për kategorinë profesionale të nëpunësve të shërbimit publik, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, në përputhje me parimet e përcaktuara në LZP.

#### **Neni 6**

##### **Organizimi i procedurave të rekrutimit**

1. Procedura e rekrutimit organizohet në mënyrë periodike për pozitën e zjarrfikësit, sipas nevojave të institucionit dhe organizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

2. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitat e shërbimit publik të zjarrfikësit bëhet nga NjMBNj-ja, në SIMBNj, në ueb-faqen e institucionit përkatës ose në mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

3. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit.

4. Shpallja e rekrutimit publikohet në pajtim me ligjin përkatës për përdorimin e gjuhëve.

## **Neni 7**

### **Përmbajtja e procedurës së rekrutimit**

1. Shpallja e rekrutimit përmban të paktën këto të dhëna:

- 1.1. vendin e punës;
- 1.2. përshkrimin e përgjithshëm të punës;
- 1.3. kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së;
- 1.4. kriteret specifike shtesë;
- 1.5. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit;
- 1.6. mënyrën e paraqitjes së aplikacioneve;
- 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve, të përcaktuar me datë të saktë;
- 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
- 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve;
- 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët;

2. Të gjitha shpalljet, gjithashtu përmbajnë këto shënime:

- 2.1. “Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre dhe gjinia më pak e përfaqësuar, kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional”.
- 2.2. “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë, nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”.

3. Kandidati, përmes aplikacionit, deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara, sipas kërkesave të përcaktuara në shpalljen e procedurës së rekrutimit.

4. Deklarimi i rrejshëm sipas këtij neni paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e rekrutimit.

## **Neni 8**

### **Kriteret specifike shitesë**

1. Kriteret që duhet t'i plotësojë një person për punësim si zjarrfikës, përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës të përcaktuara në nenin 9 të LZP-së, janë edhe këto, si në vijim:

1.1. të jetë i moshës nga 18 deri në 30 vjeç;

1.2. të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm të lartë;

1.3. të ketë aftësi psiko-fizike për të kryer aktivitetet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit.

2. Kandidatët për “zjarrfikës për operimin e automjeteve zjarrfikëse” janë kategori e zjarrfikësve, të cilët, përpos kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur me patentë shofer të kategorisë “C”.

## **Neni 9**

### **Aplikacionet e kandidatëve**

1. Kandidatët për konkurrim plotësojnë aplikacionin sipas formularit të bashkëngjitur në shpalljen konkursit.

2. Kandidatët e plotësojnë aplikacionin në gjuhën zyrtare, në pajtim me ligjin përkatës për përdorimin e gjuhëve.

## **Neni 10**

### **Përmbajtja e aplikacioneve**

1. Aplikacioni përmban të dhënat si vijon:

1.1. referencën e shpalljes së procedurës së rekrutimit;

1.2. të dhënat personale të kandidatit;

1.3. nivelin e arsimimit, si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore dhe datat e diplomimit;

1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë të dhëna si vijon:

1.4.1. emrin e punëdhënësit;

1.4.2. titullin, gradën dhe/apo të ngjashme;

1.4.3. kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës;

1.4.4. përshkrimin e detyrave kryesore të punës;

1.4.5. numrin dhe llojin e personelit nën mbikëqyrje, nëse ka;

1.4.6. adresën dhe kontaktin e punëdhënësit paraprak;

1.4.7. arsyet për përfundimin e marrëdhënies/eve paraprake të punës.

1.5. njohuritë gjuhësore;

1.6. informatat mbi trajnimet e veçanta të kryera apo të ofruara, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta, si dhe patentë shoferin të kategorisë “C”;

2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisnin edhe dokumentacionin në vijim:

2.1. kopjen e diplomës së kërkuar me konkurs, me të dhëna nga institucionet arsimore, si dhe vendimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit;

2.2. kopjet e dëshmisë së përvojës së punës (nëse ka);

2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim, të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

3. Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerjen e një veprë penale me dashje, si dhe diploma e kualifikimit arsimor, dorëzohen gjatë fazës së verifikimit para emërimit.

4. NjMBNj-ja ofron mbështetje teknike gjatë procedurës së rekrutimit, sipas kërkesës së kandidatëve.

## **Neni 11**

### **Dorëzimi i aplikacioneve**

Aplikimet dorëzohen në mënyrë fizike ose elektronike, në adresën e përcaktuar në shpalljen e procedurës së rekrutimit.

## **Neni 12**

### **Komisioni i pranimit për pozitat profesionale**

1. Vlerësimi i kandidatëve në procedurën e rekrutimit për kategorinë profesionale, bëhet nga Komisioni i Pranimit.
2. Komisioni i Pranimit themelohet nga:
  - 2.1. Drejtori Ekzekutiv i AME-së.
3. Komisioni i Pranimit përbëhet nga pesë (5) anëtarë:
  - 3.1. dy (2) nëpunës nga AME;
  - 3.2. dy (2) nëpunës nga NjPZSh; dhe
  - 3.3. një (1) përfaqësues nga NjMBNj.
4. Për secilën kategori të anëtarëve të komisionit caktohet një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rast të pamundësisë së përkohshme të anëtarit kryesor.
5. Në procedurat e rekrutimit, në cilësinë e vëzhguesve mund të marrin pjesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe sindikatat.

## **Neni 13**

### **Fazat e rekrutimit**

1. Rekrutimi zhvillohet në dy (2) faza:
  - 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve, dhe
  - 1.2. vlerësimi profesional i kandidatëve.

## **Neni 14**

### **Verifikimi paraprak**

1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.
2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj-ja, e cila e organizon rekrutimin, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.
3. NjMBNj-ja publikon në SIMBJN dhe ueb-faqen e institucionit listën e kandidatëve që i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për aplikim.

4. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet për aplikim, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej rekrutimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve nga NjMBNj-ja, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të listës.

### **Neni 15**

#### **Vlerësimi profesional i kandidatëve**

1. Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimi për kategorinë përkatëse, të përcaktuar në këtë Rregullore.

2. Vlerësimi i kandidatëve përfshinë:

2.1. vlerësimin nëpërmjet testimit me shkrim;

2.2. vlerësimin nëpërmjet testimit të shkathtësive fizike;

2.3. vlerësimin nëpërmjet intervistës;

2.4. vlerësimin nëpërmjet testimit shëndetësor.

### **Neni 16**

#### **Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim**

1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak dhe duhet të realizohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak.

2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitave përkatëse.

3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë.

5. Komisioni i Pranimi, në përbërje të plotë, është i obliguar që ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë dhe të përgatisë pyetjet e testit me shkrim sipas modelit me zgjedhje të shumëfishtë dhe me një përgjigje të saktë, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit.

6. Testi me shkrim përmban jo më pak se njëzet (20) dhe jo më shumë se tridhjetë (30) pyetje.

7. Komisioni i Pranimi përcakton peshën e secilës pyetje, duke mos kaluar maksimumin prej shtatëdhjetë (70) pikëve.

8. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) minuta.

9. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj-ja sipas vendosjes së Komisionit të Pranimi, e

përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testin me shkrim dhe e publikon atë në SIMBNJ dhe në ueb-faqen e institucionit.

10. Komisioni mban përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, për ruajtjen e informatave dhe të testit me shkrim.

### **Neni 17**

#### **Vlerësimi nëpërmjet testimit të shkathtësive fizike**

1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e shkathtësive fizike, i cili realizohet në mënyrë praktike dhe duhet të përfundojë brenda dhjetë (10) ditëve pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim.

2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim kanë të drejtë të marrin pjesë në testimin e shkathtësive fizike.

3. Standardet e testimit të shkathtësive fizike janë të përshkruara në formularin e vlerësimit të anëtarëve të komisionit për kandidatin për zjarrfikës nëpërmjet testimit të shkathtësive fizike.

4. Gjatë procesit të testimit të shkathtësive fizike, përveç Komisionit, duhet të jetë i pranishëm edhe personeli mjekësor.

5. Nëse kandidati deklaron se është në gjendje të mirë shëndetësore dhe është i gatshëm t'i nënshtrohet testit të shkathtësive fizike, nga ai kërkohet që të plotësojë dhe nënshkruajë formularin për lirimin nga përgjegjësia dhe dëmshpërblimi, në rast se gjatë këtij procesi i shkaktohet ndonjë problem shëndetësor apo lëndim fizik.

6. Vlerësimi i rezultatit të testit fizik bëhet në shtatë (7) elemente, si: vrapim, pompa, barkore, ngritja e peshave në krahavor, ngritja e peshave në këmbë, kërcim në lartësi dhe ngjitje në shkallë.

7. Vlerësimi i rezultatit të testit fizik bëhet sipas elementeve të përshkruara në formularin e vlerësimit të anëtarëve të komisionit për kandidatin për zjarrfikës nëpërmjet testimit të shkathtësive fizike. Nëse kandidati nuk arrin të kalojë me sukses njërin nga këto elemente, konsiderohet se ka dështuar.

8. Pas vlerësimit të shkathtësive fizike, NjMBNj-ja sipas vendosjes së Komisionit të Pranimit, e përpilon listën e kandidatëve që kanë kaluar testimin e shkathtësive fizike dhe e publikon atë në SIMBNJ dhe në ueb-faqen e institucionit.

9. Vlerësimi i testit të shkathtësive fizike nuk ndikon në pikët totale të kandidatëve që kanë kaluar me sukses testin në vlerësimin përfundimtar të procedurës së rekrutimit.

## **Neni 18**

### **Vlerësimi nëpërmjet intervistës**

1. Vlerësimi i kandidatëve përmes intervistës duhet të përfundojë brenda dhjetë (10) ditëve nga publikimi i listës së kandidatëve që kanë kaluar vlerësimin e shkathtësive fizike.
2. Vetëm kandidatët që kanë kaluar me sukses testin e shkathtësive fizike kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.
3. NjMBNJ-ja njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testin e shkathtësive fizike lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.
4. Në intervistë vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim.
5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimit, i cili përgatit një grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët. Këto pyetje duhet të përgatiten ose përzgjidhen në ditën e zhvillimit të intervistës.
6. Intervista në kategorinë profesionale përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti gjashtë (6) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashtrojnë edhe nënpyetje për kandidatin, me qëllim të vlerësimit më të saktë lidhur me pyetjen kryesore.
7. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje.
8. Në intervistë, kandidati mund të vlerësohet me më së shumti tridhjetë (30) pikë.
9. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve.

## **Neni 19**

### **Vlerësimi përfundimtar**

1. Komisioni harton listën me pikët e kandidatëve në testin me shkrim dhe në intervistë.
2. Vetëm kandidatët që kanë marrë shtatëdhjetë (70) pikë ose më shumë në të dy fazat konsiderohen kandidatë fitues dhe mund të vazhdojnë më tutje në procesin e rekrutimit.
3. Komisioni i Pranimit përgatit listën dhe e përcjell te NjMBNJ-ja për publikim. Lista publikohet në SIMBNJ, në ueb-faqen e institucionit dhe në mjete të tjera të përshtatshme për informim.

## **Neni 20**

### **Testimi shëndetësor**

1. Testit shëndetësor i nënshtrohen kandidatët që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë (70) pikëve, sipas renditjes, duke filluar nga kandidati me më së shumti pikë, sipas numrit të kërkuar për rekrutim.
2. Nëse ndonjë nga kandidatët nuk është në gjendje të mirë shëndetësore, sipas raportit mjekësor, ftohen kandidatët të tjerë sipas radhës, duke filluar nga kandidatët me numrin më të madh të pikëve në listë.
3. Testi shëndetësor kryhet nga institucioni i autorizuar shëndetësor, në të cilin marrin pjesë specialistë të fushave si vijon: specialisti i mjekësisë së punës, internisti, psikologu, neuropsikiatri ose psikiatri, oftalmologu dhe otorinolaringologu.
4. Institucioni i autorizuar shëndetësor lëshon raportin për gjendjen shëndetësore të kandidatit, i cili mund të jetë bazë për vendimmarrjen e Komisionit. Në bazë të këtij raporti, Komisioni vendos nëse kandidati kalon ose nuk kalon.

## **Neni 21**

### **Shpallja e rezultatit përfundimtar**

1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në testimin me shkrim dhe në intervistë, me kusht të ketë kaluar testin e vlerësimit shëndetësor.
2. Komisioni i Pranimi brenda afatit dhjetë (10) ditor pas publikimit të listës së kandidatëve, përgatit listën përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, të cilët në testin me shkrim dhe në intervistë kanë arritur të grumbullojnë më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë (70) pikë nga maksimumi i pikëve të caktuara, si dhe kanë kaluar me sukses vlerësimin shëndetësor, dhe e përcjell atë në NjMBNJ për publikim.
3. Lista publikohet në SIMBNJ, në ueb-faqen e institucionit dhe në mjete të tjera të përshtatshme për informim.

## **Neni 22**

### **Dispozita të veçanta për kandidatët me pikë të barabarta**

1. Kandidatët me pikë të barabarta renditen dhe përzgjidhen sipas kësaj radhe:
  - 1.1. nëse kandidatët janë të gjinive të ndryshme, përzgjidhet kandidati që i përket gjinisë të nën-përfaqësuar;
  - 1.2. nëse kandidatët i përkasin komuniteteve jo-shumicë, ata kanë përparësi ndaj kandidatëve nga komuniteti shumicë.

2. Gjinia më pak e përfaqësuar, sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.1 të këtij neni, përcaktohet nga NjMBNj-ja në bazë të statistikave zyrtare.

3. Në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, përzgjedhja bëhet me short.

### **Neni 23**

#### **Ankesa në procedurën e pranimit**

1. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit kanë të drejtë ankesë në Komisionin e Ankesave në kuadër të AME-së, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e publikimit të rezultateve përfundimtare.

2. Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre (3) anëtarë dhe themelohet nga Drejtori i AME-së.

3. Për procedurat dhe afatet e shqyrtimit të ankesës, si dhe për ankesën kundër vendimit të Komisionit të Ankesave, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

### **Neni 24**

#### **Verifikimi para emërimit**

1. NjMBNj, pas përzgjedhjes së kandidatit fitues për një pozitë të caktuar, bën verifikimin përfundimtar të plotësimit të kriterëve të aplikimit para emërimit të tij.

2. Verifikimi përfundimtar përfshin:

2.1. verifikimin e dokumenteve të paraqitura nga kandidati, në bazë të cilave është zhvilluar procedura e rekrutimit;

2.2. verifikimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara nga nënparagrafët 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1 të nenit 9 të LZP-së; dhe

2.3. verifikimin e vazhdimit të plotësimit të kriterëve të tjera të përcaktuara në nenin 9 të LZP- së, me përjashtim të kriterëve të përcaktuara në nënparagrafët 1.3 dhe 1.7. të paragrafit 1 të nenit 9 të LZP-së.

3. Nëse vlerësimi rezulton negativ, NjMBNj konstaton mosplotësimin e kriterëve të aplikimit, vendos përjashtimin e kandidatit dhe vazhdon me kandidatin pasues që ka arritur së paku shtatëdhjetë (70) pikë.

4. Për qëllime të verifikimit përfundimtar, NjMBNj i kërkon kandidatit paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kriterëve, në origjinal apo të njëjtësuar me origjinalin.

5. Njësia përgjegjëse, kur ka dilema lidhur me paqartësitë e dokumentacionit, mund të bëjë verifikimin sipas detyrës zyrtare, siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

## **Neni 25**

### **Themelimi i marrëdhënies së punës në kategorinë profesionale**

1. NjMBNj, pas kryerjes së verifikimit, përgatit kontratën e punës, e cila nënshkruhet nga Drejtori Ekzekutiv i AME-së dhe kandidati.
2. Pas pranimit të kontratës së punës, kandidati fitues duhet të paraqitet në institucionin ku është emëruar jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë nga data e pranimit të kontratës së punës.
3. Afati i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni mund të zgjatet, me kërkesë të kandidatit, për shkaqe të arsyeshme dhe me pajtimin e institucionit deri në një (1) muaj, duke përfshirë afatin fillestar.
4. Në rast të mosparaqitjes sipas paragrafëve 2 apo 3 të këtij neni, NjMBNj fillon procedurën për anulimin e kontratës së punës dhe kandidati humb të drejtën për emërim, përveç nëse i nënshtrohet një procedure të re të rekrutimi.
5. Në rast se NjMBNj anulon kontratën e punës sipas paragrafit 4 të këtij neni, vazhdon procedurën me emërimin e kandidatit pasues që ka arritur së paku shtatëdhjetë (70) pikë.
6. Marrëdhënia e punës themelohet në bazë të kontratës së punës dhe është marrëdhënie pune nën kushtin e konfirmimit në përfundim të periudhës së provës.
7. Marrëdhënia e punës në kategorinë profesionale themelohet për një periudhë të pacaktuar.

## **Neni 26**

### **Puna provuese**

1. Nëpunësi, pas themelimit të marrëdhënies së punës, i nënshtrohet periudhës provuese prej gjashtë (6) muajsh për nëpunësin me kontratë pune për periudhë të pacaktuar.
2. Puna provuese përfshin përgatitjen teorike dhe praktike të nëpunësit për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi të punës.
3. Zjarrfikësit, gjatë periudhës provuese, i nënshtrohen trajnimit profesional në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP). Gjatë kësaj periudhe trajtimi, ata mbajnë statusin e zjarrfikësit praktikant, ndërsa pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe konfirmimit të periudhës provuese, fitojnë statusin e zjarrfikësit.
4. Nëpunësi publik, gjatë periudhës provuese, nuk ka të drejtë të marrë pjesë në komisione përzgjedhëse, komisione disiplinore, komisione të ankesave, apo të caktohet si zëvendësues në ndonjë pozitë tjetër.

## **Neni 27**

### **Vlerësimi gjatë periudhës provuese**

1. NjMBNj, tridhjetë (30) ditë para përfundimit të periudhës provuese, i kërkon me shkrim mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit që të bëjë vlerësimin e punës provuese.
2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takim me nëpunësin, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të periudhës provuese, lidhur me performancën e tij.
3. Njoftimi për takimin lidhur me vlerësimin e punës provuese të nëpunësit i dërgohet atij së paku tre (3) ditë para datës së takimit.
  - 3.1. në fund të periudhës provuese, organi emërues, bazuar në raportin e vlerësimit të rezultateve të punës, vendos për konfirmimin e vazhdimin të marrëdhënies së punës sipas kontratës;
  - 3.2. zgjatjen e periudhës provuese, vetëm një herë, deri në gjysmën e periudhës provuese, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit;
  - 3.3. ndërprerjen e kontratës së punës.
4. Vlerësimin e arsyetuar për konfirmimin ose moskonfirmimin e punës së nëpunësit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ia dërgon NjMBNj-së së paku dhjetë (10) ditë para përfundimit të periudhës provuese.
5. Në rast të mosrekomandimit për vazhdimin e marrëdhënies së punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, organi emërues merr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
6. Organi emërues, para marrjes së vendimit për konfirmimin apo moskonfirmimin e marrëdhënies së punës, duhet të sigurohet se gjatë punës provuese nëpunësi ka qenë nën kujdesin e vazhdueshëm të një nëpunësi tjetër, të caktuar nga organi emërues dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

## **Neni 28**

### **Ankesa kundër vendimit për moskonfirmimin e marrëdhënies së punës në fund të periudhës provuese**

1. Nëpunësi, të cilit nuk i konfirmohet vazhdimi i marrëdhënies së punës, mund të paraqesë ankesë kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankesave, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.
2. Institucioni është i detyruar ta mbajë vendin e lirë të punës deri në zgjidhjen e ankesës nga Komisioni i Ankesave ose deri në përfundimin e afatit për paraqitjen e saj.

## **Neni 29**

### **Shtojcat**

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë shtojcat si në vijim:

- 1.1. Shtojca nr. 1 - Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë;
- 1.2. Shtojca nr. 2 – Formulari i Vlerësimit të Anëtarëve të Komisionit për Kandidatin për Zjarrfikës përmes Testimit të Shkathtësive Fizike.
- 1.3. Shtojca Nr. 3 - Lista Përfundimtare e Vlerësimit të Kandidatëve.

## **Neni 30**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës  
31 korrik 2026



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**SHTOJCA 1**

**FORMULARI I VLERËSIMIT INDIVIDUAL TË ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR  
KANDIDATIN NË INTERVISTË**

**Pozita e punës:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe mbiemri i kandidatit:** \_\_\_\_\_

| Fusha e vlerësimit | Pikët maksimale | Vlerësimi i anëtarit | Koment apo vërejtje nga anëtari i komisionit (nëse ka). |
|--------------------|-----------------|----------------------|---------------------------------------------------------|
| Pyetja 1           | 0-6             |                      |                                                         |
| Pyetja 2           | 0-6             |                      |                                                         |
| Pyetja 3           | 0-6             |                      |                                                         |
| Pyetja 4           | 0-6             |                      |                                                         |
| Pyetja 5           | 0-6             |                      |                                                         |
| TOTALI:            |                 |                      |                                                         |

**Anëtari i Komisionit të Pranimi - Emri dhe mbiemri:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

**SHTOJCA 2**

**FORMULARI I VLERËSIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR KANDIDATIN  
PËR ZJARRFIKËS PËRMES TESTIMIT TË SHKATHTËSIVE FIZIKE**

Gjinia: \_\_\_\_\_, Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_/Nr. \_\_\_\_\_

| Elementet                             | NGRITJA E<br>PESHËS 30-45 kg<br>1 minutë |             | POMPA<br>10 sec. | BARKORE<br>30 sec. | TESTI I<br>ABALLAKUT<br>Kërcimi në<br>lartësi | TESTI I<br>KUPERIT<br>Vrapim:<br>13 minutë | NGJITJA<br>NË<br>SHKALLË<br>12-14 m | Vlerësimi    |
|---------------------------------------|------------------------------------------|-------------|------------------|--------------------|-----------------------------------------------|--------------------------------------------|-------------------------------------|--------------|
|                                       | Kraharorë                                | Këmbë       |                  |                    |                                               |                                            |                                     |              |
|                                       | 1                                        | 2           | 3                | 4                  | 5                                             | 6                                          | 7                                   |              |
| Njësia matëse                         | (numër)                                  | (numër<br>) | (numër)          | (numër)            | (centimetra)                                  | (metra)                                    | (metra)                             |              |
| <b>Gj. F. Norma<br/>e vlerësimit:</b> | ≥ 14                                     | ≥ 14        | ≥ 8              | ≥ 15               | ≥ 32                                          | ≥ 2160                                     | ≥ 12-14                             | <b>Kalon</b> |
| <b>Gj. M. Norma e<br/>vlerësimit:</b> | ≥ 21                                     | ≥ 20        | ≥ 11             | ≥ 18               | ≥ 40                                          | ≥ 2533                                     | ≥ 12-14                             | <b>Kalon</b> |
| <b>Rezultati i<br/>arritur:</b>       |                                          |             |                  |                    |                                               |                                            |                                     |              |

*Vërejtje: Nëse rezultati i arritur i kandidatit në cilëndo nga elementet e lartcekura është më i vogël se norma e vlerësimit, konsiderohet se kandidati ka dështuar në testin e shkathhtësive fizike “Nuk kalon”.*

Përshkrim i shkurtër: \_\_\_\_\_

(Mospjesëmarrja e kandidatit; suksesi i arritur; -të cekët elementi negativ i testit; etj.)

**Komisioni i Pranimit:**

**Nënshkrimi:**

Anëtari 1. \_\_\_\_\_

Anëtari 2. \_\_\_\_\_

Anëtari 3. \_\_\_\_\_

Anëtari 4. \_\_\_\_\_

Anëtari 5. \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_

**Vendi i mbajtjes së testimit:** \_\_\_\_\_



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

---

**SHTOJCA 3**

**LISTA PËRFUNDIMTARE E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

| <b>Kandidati</b> | <b>Pikët e testit<br/>me shkrim</b> | <b>Pikët e<br/>intervistës</b> | <b>Pikët e përgjithshme</b> |
|------------------|-------------------------------------|--------------------------------|-----------------------------|
|                  |                                     |                                |                             |
|                  |                                     |                                |                             |

**Komisioni i Pranimi:**

**Anëtari 1** \_\_\_\_\_

**Anëtari 2** \_\_\_\_\_

**Anëtari 3** \_\_\_\_\_

**Anëtari 4** \_\_\_\_\_

**Anëtari 5** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_